

VENDIM
Nr. 560, datë 15.7.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 425, DATË 27.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË SUBJEKTEVE TË PAJISURA ME LICENCË PËR PROJEKTIM, ZBATIM, MBIKËQYRJJE DHE KOLAUDIM NË PASURITË KULTURORE, PËR KRYERJEN E INVESTIMEVE ME FONDE PUBLIKE NË PASURITË KULTURORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 90, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 425, datë 27.5.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun II bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijojnë:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Institucioni/autoriteti kontraktor, që disponon fondin publik për hartimin e projektit të ndërhyrjes, të zbatimit të punimeve, të mbikëqyrjes dhe të kolaudimit në pasuri kulturore, fillon procedurat e konkurrimit publik, me urdhrin për ngritjen e Komisionit të Konkurrimit (në vijim Komisioni).".

b) Shkronja "F", e pikës 14, ndryshohet si më poshtë vijon:

"f) të ketë përvojë të mëparshme në kryerjen e ndërhyrjeve ruajtëse të projektimit, të zbatimit, të mbikëqyrjes dhe të kolaudimit në pasuritë kulturore, deri në masën 50% të vlerës së fondit limit të procedurës së konkurrimit.".

c) Në fund të pikës 22 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Në rastin e procedurave të konkurrimit për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë për projektim, kriteri i përcaktimit të ofertës fituese është oferta ekonomikisht më e favorshme.".

ç) Pas pikës 22 shtohen pikat 22/1, 22/2 dhe 22/3, me këtë përmbajtje:

"22/1. Pas hapjes së ofertave, Komisioni mund të anulojë procedurën, në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë ofertë;

b) nuk është kualifikuar asnjë ofertë e vlefshme;

c) ofertuesi/ofertuesit i/e kualifikuar tërhiqen para lidhjes së kontratës ose nuk pranon/jnë të bëj/në sigurimin e kontratës;

ç) për arsye dhe shkaqe që nuk varen nga vullneti i institucionit/autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës.

Komisioni nuk mban përgjegjësi për vendimin e marrë, në bazë të kësaj pike, ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta. Vendimi u komunikohet të gjithë ofertuesve, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij, bashkë me arsyet. Brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e vendimit të anulimit bëhet njoftimi në të njëjtën mënyrë siç është bërë edhe njoftimi i kontratës.

22/2. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

22/3. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, Komisioni verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët, sipas formulës së përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.".

d) Pas pikës 23 shtohet pika 23/1, me këtë përmbajtje:

"23/1. Procedurat përzgjedhëse të subjekteve të pajisura me licencë për projektim janë procedura konkurrimi me faza.".

dh) Në pikën 24, pas fjalëve "... të këtij vendimi" shtohen fjalët "... me përjashtim të rasteve kur procedura e konkurrimit zhvillohet nga organi i vetëqeverisjes vendore, në administrimin e të cilit ndodhet pasuria kulturore".

2. Pas pikës 10, të kreut III, shtohet pika 11, me këtë përmbajtje:

"11. Në rastin e zhvillimit të procedurave të konkurrimit nga organet e vetëqeverisjes vendore, vendimi i marrë nga titullari i institucionit/autoritetit kontraktor, sipas pikës 3 të këtij kreu, është përfundimtar nga ana administrative."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe